

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"A2-EUROPROJECT"

Ne Tirane, sot me date **31.05. 2024** (dymije e njezet e kater), une i nenshkruari e meposhtem, ortak i vetem:

- **Viorel NEZIRI**, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi dhe banues në Tiranë, lindur më 22.05.1984, me leternjoftim Nr.036029428 dhe Nr.Personal I40522020F.

me cilesine e "Ortakut TE VETEM Themelues", redaktoj kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklaroj se me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare ", me ndryshimet perkatese, ne ligjin "Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin " A2-EUROPROJECT " shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "A2-EUROPROJECT" Sh.P.K., më poshtë shoqëria.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "A2-EUROPROJECT" SHPK, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personat fizikë të sipërpervendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Neni 3

Selia

Selia e shoqërisë si dhe adresa e saj ligjore do të jetë Lagjia Nr.17, Rruga Drenica, pranë Galaktikut, objekti nr.7684, Durrës.

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme si:

- Ndërtim, studim, projektimit dhe supervizimit të cdo lloji punimi në fushën e ndërtimit ndërtimit të cdo lloji kategorie, si infrastrukturë, punime civile, industriale, mekanike, elektrike, hidraulike, etj;
- Zbatimit të punimeve të ndërtimit si: Ndërtime Civile dhe Industriale, rikonstruksione godinash, veshje fasadash etj.
- Veprimtari ekonomike në fushën e Real Estate & rikonstruksion, projekte, zbatim, mobilim.

- Blerje dhe dhenie me qera e ndërtesave;
- Blerje, shitje, shkëmbim, valorizim, tregtim I tokave dhe ndërtesave;
- Analize dhe preventive, ndërtime, ristrukturime, shkatërtime, rindërtime dhe rikuperime ndërtimorë të godinave, ndërtesave civile, dhe industriale, rustike;
- Analizë dhe preventive, realizim, administrim dhe mirëmbajtje e veprave të vogla dhe të mëdha infrastrukturore;
- Analizë dhe preventivë, realizim I cdo lloj veprave dhe pune ndërtimi;
- Marrje dhe dhënie me qera, administrim dhe menazhim pasurish të patundshme në përgjithësim në pronësi publike dhe private;

Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk ndalohet nga ligji i zbatueshëm. Për arritjen e këtij qëllimi dhe kryerjen e veprimtarisë, Shoqëria ka të drejtën të bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose me cilëndo tjetër Shoqëri me të njëjtin objekt brenda vendit ose jashtë vendit që ka të njëjtin qëllim.

Neni 5 Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do jetë për një afat kohor të pakufizuar.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 10000 Lek (dhjetë mijë) dhe është i përbërë nga 1 (një) kuote.

1. **Viorel NEZIRI, me letërnjoftim Nr.036029428 dhe Nr.Personal I40522020F**, Zoterues i 1 (një) Kuote, që përben 100 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 10000 (dhjetë mijë) leke.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicë të parashikuara për ndryshimin e statutit

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të treta jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilesuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) cheshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e pergjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave te zoteruesve te kapitalit te shoqerise, qe jane pjesmarres ne mbledhje.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për cheshtje te tjera si :


- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyquar ndryshimet ne skeden e shoqerise

Neni 10
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator.

Administrator i shoqerise eshte **Z.Viorel Neziri**, i cili do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe **5 vjecare me te drejte ripertesitje**.



Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13 Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Neni 14 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 15 Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16 Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe. Ky akt pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare **ne krijim e siper**, neshkruhet rregullisht prej nesh ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen tone origjinale.

Ngarkohet **ortaku i vetem i shoqerise dhe administratori njekohesisht, Viorel Neziri**, per depozitim te ketyre akteve prane QKB.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

VIOREL NEZIRI

